



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryemnisitrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

**RREGULLORE (ZKM) NR. 06/2026 PËR ORGANIZIMIN E
BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË
INSPEKTORATIN QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT¹**

¹ Rregullorja (ZKM) Nr. 06/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është miratuar nga Kryeministri në detyrë me Vendimin Nr. 352/2026, të datës 11.02.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut si dhe nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 06/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË INSPEKTORATIN QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës së Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (në vijim: IQMT).

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ku parimet dhe procedurat e përgjithshme të IQMT-së përcaktohen me Ligjin për Inspektimet dhe kompetencat e përgjithshme me ligjin përkatës të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Neni 3 Misioni

IQMT është agjenci ekzekutive pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i themeluar me ligj, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit përkatës në fuqi në fushën e inspektimeve dhe të Mbikëqyrjes së Tregut, në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, në fushën e tregtimit me Naftë dhe Derivate të Naftës, fushën e sigurisë së produkteve dhe vlerësimit të konformitetit, fushën e metaleve të çmuara, për markat tregtare, fushën e tregtisë së brendshme dhe shërbimeve, fushën e turizmit, fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta, fushën për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtinë e Duhanit, fushën e Produkteve të Ndërtimit, mbrojtjen e konkurrencës së drejtë, luftimin e informalitetit dhe praktikave të padrejta tregtare, bashkëpunon me institucione të ndryshme, bën vlerësimin e rrezikut të produkteve në baza të rregullta dhe harton planin për inspektimin e tyre me qëllim të garantimit të sigurisë të të gjitha mallrave dhe shërbimeve që qarkullojnë në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Struktura organizative e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

1. Struktura funksionale apo organizative e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është si vijon:
 - 1.1. Zyra e Kryeinspektorit;
 - 1.2. Divizioni i Inspektimeve dhe
 - 1.3. Divizioni për çështje administrative.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeinspektorit përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësit civil të Zyrës së Kryeinspektorit përcaktohen me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë.
4. Numri i të punësuarve në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut është dyzet e tetë (48) nëpunës.

Neni 5

Zyra e Kryeinspektorit

1. Zyra e Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut përbëhet nga:
 - 1.1. Kryeinspektori;
 - 1.2. Asistent administrativ
2. Numri i të punësuarve në Zyrën e Kryeinspektorit është dy (2) nëpunës civil.

Neni 6

Divizioni i Inspektimeve

1. Misioni i Divizionit të Inspektimeve është mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit përkatës në fuqi në fushën e inspektimeve dhe të Mbikëqyrjes së Tregut, në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, në fushën e tregtimit me Naftë dhe Derivate të Naftës, fushën e sigurisë së produkteve dhe vlerësimit të konformitetit, fushën e metaleve të çmuara, për markat tregtare, fushën e tregtisë së brendshme dhe shërbimeve, fushën e turizmit, fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta, fushën për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtinë e Duhanit, fushën e Produkteve të Ndërtimit, mbrojtjen e konkurrencës së drejtë, luftimin e informalitetit dhe praktikave të padrejta tregtare, bashkëpunon me institucione të ndryshme, bënë vlerësimin e rrezikut të produkteve në baza të rregullta dhe harton planin për inspektimin e tyre me qëllim të garantimit të sigurisë të të gjitha mallrave dhe shërbimeve që qarkullojnë në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Inspektimeve janë:

- 2.1. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e inspektimeve dhe të Mbikëqyrjes së Tregut;
- 2.2. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- 2.3. Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe procedurave teknike në fushën e tregtimit me Naftë dhe Derivate të Naftës;
- 2.4. Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe procedurave teknike në fushën e sigurisë së produkteve dhe vlerësimit të konformitetit;
- 2.5. Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe procedurave teknike në fushën e metaleve të çmuara;
- 2.6. Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe procedurave teknike në fushën për markat tregtare;
- 2.7. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e tregtisë së brendshme dhe shërbimeve;
- 2.8. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e turizmit;
- 2.9. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta;
- 2.10. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën për prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtinë e Duhanit;
- 2.11. Mbikëqyrë dhe zbaton legjislacionin përkatës në fuqi në fushën e Produkteve të Ndërtimit;
- 2.12. Ndërmerr veprime inspektuese për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;
- 2.13. Koordinon aktivitetet dhe bashkëpunon me organet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit përkatës në fuqi;
- 2.14. Ndërmerr veprime inspektuese për mbrojtjen e konkurrencës së drejtë, luftimin e informalitetit dhe praktikave të padrejta tregtare;
- 2.15. Bashkëpunon me Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës për verifikim të përbërjes së deklaruar të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore si dhe të karburanteve të lëngëta të Naftës;
- 2.16. Bashkëpunon me Doganën e Kosovës sipas modeleve për vlerësim të riskut;
- 2.17. Koordinon aktivitetet dhe bashkëpunon me institucionet e tjera përkatëse dhe me laboratorët për testimin dhe verifikimin e sigurisë së produkteve;

- 2.18. Bën vlerësimin e rrezikut të produkteve në baza të rregullta dhe harton planin për inspektimin e tyre;
 - 2.19. Garanton sigurinë e të gjitha mallrave dhe shërbimeve që qarkullojnë në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës;
 - 2.20. Në bazë të publikimit të produkteve në sistemin RAPEX, largon produktet e rrezikshme të cilat hasen në tregun e brendshëm të Republikës së Kosovës;
 - 2.21. Ndërmerr masa ndëshkuese për shkeljet e konstatuara konform legjislacionit në fuqi;
3. Udhëheqësi i Divizionit të Inspektimeve raporton tek Kryeinspektori.
 4. Numri i nëpunësve në këtë Divizion është dyzet e një (41) nëpunës.

Neni 7

Divizioni për çështje administrative

1. Misioni i Divizionit për çështje administrative është ofrimi i mbështetjes profesionale për zyrtarët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut për të garantuar zbatimin e ligjeve për të cilat ka kompetencë të mbikëqyrjes Inspektorati Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për çështje administrative janë:
 - 2.1. Ofron ndihmë juridike dhe organizative për të gjitha strukturat organizative të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;
 - 2.2. Ofron mbështetje juridike në trajtimin e lëndëve që adresohen në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe harton projekt vendimet përkatëse dhe shkresat e tjera juridike konform legjislacionit në fuqi;
 - 2.3. Harton aktet juridike në përputhje me procesverbalet e inspektimeve;
 - 2.4. Ofron ndihmë juridike në hartimin dhe zhvillimin e procedurave për mbikëqyrjen tregut;
 - 2.5. Bën menaxhimin, realizimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave të IQMT-së;
3. Udhëheqësi i Divizionit për çështje administrative raporton tek Kryeinspektori.
4. Numri i nëpunësve në Divizionin për çështje administrative është pesë (5).

Neni 8
Shërbimet e Përgjithshme

Për kryerjen e shërbimeve të përgjithshme për IQMT obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 10/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Inspektoratit të Tregut.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

11 shkurt 2026

Shtojca 1

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Nr.	Tot.
1. Zyra e Kryeinspektorit				2
Kryeinspektori	Drejtues i Nivelit të Lartë			1
Asistent Administrativ	Profesional 3	64 Gr. i Administrimit të përgjithshëm		1
2. Divizioni i Inspektimeve				41
Udhëheqës i Divizionit të Inspektimeve	Drejtues i nivelit të ulët			1
Inspektor i Tregut	Profesional 1	63. Gr. i Administrimit të përgjithshëm		40
3. Divizioni për çështje administrative				5
Udhëheqesi i Divizionit për çështje administrative	Drejtues i nivelit të ulët			1
Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore	Profesional 1	1. Grupi ligjor		3
Zyrtar për përpunimin e raporteve financiare	Profesional 2	2. Grupi i buxhetit dhe financave		1
				48

